

“A&V-Gas” Sha
Pasqyrat Financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2014
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	6
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 19

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Aksionerët e Shoqërisë "A&V- Gas"sha

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "A&V-Gas" sha (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 dhjetor 2014 si dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit- e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.


Bazat për opinion me rezervë

Siç përshkruhet në shënimin 5 dhe 11 të pasqyrave financiare, gjëndja e llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme më 31 dhjetor 2014 paraqitet përkatësisht në vlerat 1,160,240,678 lekë dhe 1,719,556,534 lekë. Deri në datën e raportit të auditimit ne nuk kemi përfunduar një pjesë të rëndësishme të procedurave të auditimit në lidhje me marrjen e konfirmimeve direkte nga palët e treta. Pas përfundimit të procedurave alternative ne nuk arritëm të përfitonim një siguri të arsyeshme në lidhje me saktësinë e shumave të përfshira në këto zëra të pasqyrave financiare.

Opinion me rezervë

Sipas opinionit tone, me përjashtim te efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare të Shoqërisë "A&V-Gas" sha japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

30 Korrik 2015


Irena Hoxha (Pulo)
Partner Angazhim



A&V-GAS sh.a.
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
 (Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
 Më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	12,179,699	8,343,440
Llogari të arkëtueshme	5	1,160,240,678	956,060,805
Aktive të tjera afatshkurtra	6	1,313,429,118	676,886,557
Inventari	7	110,731,720	427,390,932
Total Aktive afatshkurtra		2,596,581,215	2,068,681,734
Aktivët afatgjatë			
Llogari të tjera të arkëtueshme	8	107,000,000	5,000,000
Aktive afatgjatë materiale	9	17,019,764	5,935,867
Aktive afatgjatë jomateriale		25,000	25,000
Total Aktivët afatgjatë		124,044,764	10,960,867
Total Aktive		2,720,625,979	2,079,642,601
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	203,751,068	266,959,202
Llogari të pagueshme tregtare	11	1,719,556,534	1,033,367,457
Parapagimet e arkëtueshme	12	6,650,217	5,622,529
Detyrime ndaj shtetit	13	373,182	297,538
Llogari të pagueshme të tjera	14	10,000	192
Total Detyrime afatshkurtra		1,930,341,001	1,306,246,918
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	15	525,504	53,898,049
Total Detyrime afatgjatë		525,504	53,898,049
Totali i Detyrimeve		1,930,866,505	1,360,144,967
Kapitali			
Kapitali aksionar		310,000,000	310,000,000
Rezerva të tjera		393,997,634	238,283,118
Rezerva ligjore		15,500,000	12,465,393
Fitimi i ushtrimit		70,261,840	158,749,123
Total Kapitali	16	789,759,474	719,497,634
Totali i Kapitalit dhe Detyrimeve		2,720,625,979	2,079,642,601

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Të ardhura	17	5,690,725,264	5,623,698,894
Të ardhura të tjera	17	61,241,335	63,972,016
Materiale të para dhe të konsumueshme	18	(5,536,222,153)	(5,354,876,245)
Shpenzime personeli	19	(13,631,732)	(13,096,477)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	9	(1,489,346)	(1,582,480)
Shpenzime të tjera	20	(136,070,596)	(148,680,908)
Fitimi operativ		64,552,772	169,434,800
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		(17,697,173)	(17,790,196)
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit	21	37,525,524	27,773,123
Total shpenzime financiare		19,828,351	9,982,927
Fitimi para tatimit		84,381,123	179,417,727
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(14,119,283)	(20,668,604)
Fitimi i vitit		70,261,840	158,749,123

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

A&V-GAS sh.a.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	68,948,051	238,283,118	-	253,517,342	560,748,511
Fitimi i vitit				158,749,123	158,749,123
Rritje e kapitalit aksionar	241,051,949			(241,051,949)	-
Transferim në rezervën ligjore			12,465,393	(12,465,393)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-
31 Dhjetor 2013	310,000,000	238,283,118	12,465,393	158,749,123	719,497,634
Transferim në fitime të mbartura					-
Fitimi i vitit				70,261,840	70,261,840
Rritje e rezervës ligjore		155,714,516	3,034,607	(158,749,123)	-
Dividendë të paguar					-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-
31 Dhjetor 2014	310,000,000	393,997,634	15,500,000	70,261,840	789,759,474

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 u aprovuan nga A&V-GAS sh.a. dhe u nënshkruan si më poshtë më ___ Mars 2015 nga:

Orledia Bare
Administratore

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014

	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	84,381,123	179,417,727
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,489,346	1,582,480
Shpenzime për interesa	17,697,173	17,790,196
Tatimi mbi fitimin		
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	103,567,642	198,790,403
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	316,659,212	(80,371,660)
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera	(840,722,434)	106,802,870
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	624,094,083	(86,780,629)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	203,598,503	138,440,984
Interesa të paguara	(17,697,173)	(17,790,196)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(14,119,283)	(20,668,604)
Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative	171,782,047	99,982,184
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(12,973,243)	(595,204)
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale		(25,000)
Shitje të aktiveve afatgjata materiale	400,000	0
Blerje e shoqërisë së kontrolluar minus parate e arketuara	(102,000,000)	(3,000,000)
Interesa të marra		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(114,573,243)	(3,620,204)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkrter		
Shtesa/pakesime në qera financiare	(53,372,545)	(99,213,528)
Dividendë paguar		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(53,372,545)	(99,213,528)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	3,836,259	(2,851,548)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	8,343,440	11,194,988
Mjetet monetare në fund të periudhës	12,179,699	8,343,440

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "A&V-GAS" Sha është krijuar më 23 Tetor 2009. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji nr. 7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria A&V-GAS është një shoqëri Shqiptare me perfaqësues ligjor znj. Orledia Bare. Ortaku i vetëm i shoqërisë është z. Pirro Bare i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit.

Selia e shoqërisë është: 700 MI në veri të Hidrovorit, Porto-Romano, Durrës. Ajo është regjistruar pranë organeve tatimore të rrethit Durrës me NIPT K922235030.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është tregtia me pakicë, shumicë si dhe shpërndarja e naftës, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, ndërtimi dhe marrja me qera e fabrikave, instalimeve dhe rafinerive për rafinimin, prodhimin, përpunimin dhe depozitimin e hidrokarbureve, transporti kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet agjensive detare e tokësore spedicionare etj.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, është përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjate periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë perllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të perllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

POLITIKAT KONTABËL (vazhdim)**3.3 Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit	Norma e Amortizimit	Metoda
	2014	2013	
Toka	0	0	
Ndetime e instalime	5	5	
Makineri e Pajisje	20	20	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Mjete transporti	20	20	
Pajisje zyre	20	20	
Pajisje kompjuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e Inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

POLITIKAT KONTABËL (vazhdim)**3.5 Provigjonet**

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga mallrat e shitura apo shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likujditeteve për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	2014	2013
Arka	263,539	196,425
Banka	11,916,160	8,147,015
	<u>12,179,699</u>	<u>8,343,440</u>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë të drejta të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	2014	2013
Llogari të arkëtueshme tregtare	1,160,240,678	956,060,805
	<u>1,160,240,678</u>	<u>956,060,805</u>

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta për Tatim fitimin e parapaguar, TVSH-në për t'u rimbursuar, të drejta ndaj ortakëve të Shoqërisë dhe të drejta të tjera si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Detyrim TVSH-je në Doganë	2,447,598	3,501,879
TVSh e Zbritshme	28,532,723	46,968,212
Tatim fitimi	7,646,087	1,517,741
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	872,982,869	600,135,552
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	401,819,841	24,763,173
	<u>1,313,429,118</u>	<u>676,886,557</u>

7. INVENTARI

Inventari i Shoqërisë i përbërë nga gazi i lëngshëm më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet me vlerat e mëposhtme:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Mallra	110,731,720	427,390,932
	<u>110,731,720</u>	<u>427,390,932</u>

8. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 përbëhen nga pjesëmarrja në njësi të tjera të kontrolluara si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Pjesëmarrje në shoqëri të kontrolluara	97,000,000	5,000,000
Garanci bankare	10,000,000	
	<u>107,000,000</u>	<u>5,000,000</u>

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Makineri & paisje	Mjete transporti	Të tjera	Në proces	Totali
Kosto					
Gjendja më 31 Dhjetor 2012		7,340,950	1,464,159		8,805,109
Shtesa			595,204		595,204
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	0	7,340,950	2,059,363	0	9,400,313
Shtesa	564,456	2,610,695	913,892	8,884,200	12,973,243
Nxjerrje jashtë përdorimit		(400,000)			400,000
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	564,456	9,551,645	2,973,255	8,884,200	21,973,556
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 31 Dhjetor 2012		1,313,695	568,271		1,881,966
Amortizimi i vitit		1,205,451	377,029		1,582,480
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	0	2,519,146	945,300	0	3,464,446
Amortizimi i vitit	80,394	1,065,801	343,151		1,489,346
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	80,394	3,584,947	1,288,451	0	4,953,792
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	0	6,027,255	895,888	0	6,923,143
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	0	4,821,804	1,114,063	0	5,935,867
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	484,062	5,966,698	1,684,804	8,884,200	17,019,764

10. HUA AFATSHKURTRA

Kjo llogari paraqet detyrimin e dy overdrafteve marrë nga Shoqëria për mjete qarkulluese sipas tabelës më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Hua Afatshkurtra (Overdraft)	203,751,068	190,485,307
Bankat	-	76,473,895
	<u>203,751,068</u>	<u>266,959,202</u>

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Ky zë paraqet detyrimin ndaj furnitorëve për furnizime me mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet e përlogaritura më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 të cilat paraqiten si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Llogari të pagueshme Tregtare	1,719,556,534	1,033,266,649
Shpenzime të përlogaritura	-	100,808
	<u>1,719,556,534</u>	<u>1,033,367,457</u>

12. PARAPAGIMET E ARKËTUESHME

Në këtë zë paraqiten parapagimet e klientëve për blerje gazi të cilat më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Parapagime të arkëtueshme	6,650,217	5,622,529
	<u>6,650,217</u>	<u>5,622,529</u>

13. DETYRIME NDAJ SHTETIT

Teprica e detyrimeve ndaj shtetit për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	273,326	208,008
Tatim mbi të ardhurat personale	99,856	89,530
	<u>373,182</u>	<u>297,538</u>

14. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet të tjera më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 përbëhen nga detyrime për paga ndaj punonjësve dhe paraqiten si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Paga e shpërblime	10,000	192
	<u>10,000</u>	<u>192</u>

15. HUA AFATGJATË

Zëri hua afatgjatë më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 përbëhet si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Hua Bankare	-	53,898,049
Qera financiare	525,504	-
	<u>525,504</u>	<u>53,898,049</u>

16. KAPITALI**Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i Shoqërisë është në vlerën 310,000,000 Lekë (2013: 310,000,000).

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore është rritur me 3,034,607 Lekë nga viti i mëparshëm dhe është në vlerën 15,500,000 Lekë.

Rezerva të tjera

Rezerva të tjera paraqiten në shumën prej 393,997,634 Lekë.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 70,261,840 Lekë përfaqëson fitimin e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

17. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Shitje mallrash	5,690,725,264	5,623,698,894
Të ardhura nga shërbime (Agjensi Detare)	36,135,189	25,846,871
Të tjera shitje e shërbime	25,106,146	38,125,145
	<u>5,751,966,599</u>	<u>5,687,670,910</u>

Gjatë vitit 2014 shoqëria ka shitur aktive materiale afatgjata me kosto sic detajohet më poshtë.

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Vlera e shitjes së AAM-ve	400,000	-
Vlera kontabel neto e AAM-ve	(400,000)	-
Rezultati nga shitja e AAM-ve	<u>-</u>	<u>-</u>

Tabela më poshtë paraqet rakordimin e të ardhurave për shifren e afarizmit:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshem	5,761,746,535
Zbriten Parapagimet	(1,027,688)
Zbriten Autofaturimet	(7,951,197)
Rregullime inspektori	(801,051)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	5,751,966,599
Sipas Kontabilitetit	<u>5,751,966,599</u>
Diferenca	<u>-</u>

18. MATERIALE TË PARA DHE TË KONSUMUESHME

Kosto e materialeve të para dhe të tjera të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Kosto e mallrave të shitura	5,536,222,153	5,354,876,245
	<u>5,536,222,153</u>	<u>5,354,876,245</u>

19. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Pagat e personelit	11,952,759	11,538,900
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,678,973	1,557,577
	<u>13,631,732</u>	<u>13,096,477</u>

*(Vlerat janë në Lek)***20. SHPENZIME TË TJERA**

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Shpenzime për blerje materiale	932,009	659,747
Shpenzime qira	15,600,000	48,903,750
Shpenzime mirmbajtje dhe riparime	706,420	804,585
Sigurime	94,571	21,000
Publicitete&reklama	713,400	702,700
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	2,220,352	1,195,756
Shpenzime telefonie	1,026,204	1,274,017
Transport dhe shitje	27,468,745	42,531,422
Shërbime bankare	13,055,377	7,115,560
Tarifa dhe taksa	50,284	15,120
Shpenzime përfaqësimi	-	134,970
Gjoha dhe dëmshpërblime	9,747,445	25,139,954
Shpenzime të tjera	64,455,789	20,182,327
	<u><u>136,070,596</u></u>	<u><u>148,680,908</u></u>

21. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Fitim nga kursi i kembimit	37,525,524	27,832,973
Humbje nga kursi i kembimit	-	(59,850)
Efekti neto nga kursi i kembimit	<u>37,525,524</u>	<u>27,773,123</u>
Të ardhura nga interesat	1,706	3,303
Shpenzime për interesat	(17,698,879)	(17,793,499)
Efekti neto nga interesat	<u>(17,697,173)</u>	<u>(17,790,196)</u>
	<u><u>19,828,351</u></u>	<u><u>9,982,927</u></u>

22. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%).

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Fitimi i periudhes	84,381,123	179,417,727
Shpenzime të panjohura	<u>9,747,248</u>	<u>27,268,314</u>
Pakësime për të Ardhura të Patatueshme (Rivleresime Tatimore)		2,128,360
Total shpenzime të panjohura	<u>9,747,248</u>	<u>25,139,954</u>
Fitimi i tatueshëm për periudhen	94,128,551	206,686,041
Norma e tatim fitimit	15%	10%
Tatim fitimi	<u>14,119,283</u>	<u>20,668,604</u>
Tatim fitimi i parapaguar		
Tatim fitimi për tu paguar	14,119,283	20,668,604

23. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA

Gjëndjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Gjëndjet në fund të vitit		
Klientë palë të lidhura	108,708,378	43,572,000
Aktive të tjera afatshkurtra - palë të lidhura	1,006,042,201	
Furnitor - palë të lidhura	935,102	44,243
Levizjet me palët e lidhura		
Blerje nga palët e lidhura	81,378,557	104,167,493
Shitje nga palët e lidhura	463,014,350	463,470,397
Perfitime te administratorit	2,881,250	2,880,000

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

24. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Më 31 Dhjetor 2014 shoqëria ka qera operative si më poshtë:

	<u>2014</u>
Deri në një vit	5,400,000
Nga një deri në pesë vite	<u>18,000,000</u>
	<u><u>23,400,000</u></u>

25. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

MAZARS SHPK

Address: Rruga Emin Duraku,
Pall. Binjaket, No.5
Tirana, 1000
Tel. +355 4 222 2889
Fax. +355 4 222 2889
E-mail: audit@mazars.al

www.mazars.al